



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM
Nr 55 Datë 23.6.08

Për transferim fondi nga Projekti “Konkursi Sotiri” në Projektin
“Karnavalet e Korçës”

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e politikave të zhvillimit, Planifikimit strategjik dhe Koordinimit me Donatorët dhe Drejtoria e Finances për “detajimin e fondit të miratuar me VKB nr. 12, datë 18.03.2008 për implementimin e projekteve prioritare për vitin 2008”, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32 pika “dh”, ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 “Për buxhetin lokal”, Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2008”. Udhëzimin nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008”. Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme “Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008”, si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e transferimit të fondit prej 260.000 lekë nga projekti “Konkursi Sotiri” në projektin “Karnavalet e Korçës”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Marketingut.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit
Raimonda NASE
Raimonda NASE